



SRPSKA LISTA (SL)

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

Zgjedhjet e Lokale në Republikën e Kosovës
16 Shtator 2021 deri me 12 Nëntor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informacionet e përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-13

Raport i Auditorëve të pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partisë "SRPSKA LISTA"

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet komunale të bashkëngjitura të Subjektit Politik "Srpska Lista" (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "SL"), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare më 12 Nentor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të fushatës për zgjedhjet e komunale me date 12 Nentor të vitit 2021 të subjektit Subjektit Politik "Srpska Lista Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të fituar një bazë për një opinion të auditimit.

Baza për Mohim të dhënies Opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurine, ekuitetin dhe detyrimet me 12 Nentor 2021 dhe 16 Shtator 2021 ashtu sic kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Duke pas parasysh natyrën e shenimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të percaktojmë korigjimet e nevojshme me 12 Nentor 2021 dhe 16 Shtator 2021. Për më tepër Subjekti politik nuk ka plotësuar drejt gjendjen e parase dhe ekuivalenteve të parase me 12 Nentor 2021 dhe 16 Shtator 2021.
- Ashtu sic është shpalosur në shenimin 2 Shpenzimet, subjekti politik ka deklaruar shpenzime për periudhën raportuese vlerën 29,302 EUR. Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar se shpenzimet në vlerë 17,102 EURO nuk i takojnë shpenzimeve të fushatës.

Theksim i çështjes

Ne gjithashtu terheqim vëmendjen për gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik "Srpska Lista" e ka të definuar me statut kontrollin e brendshëm financiar, me statut është parapare që me një akt të veçantë të Bordit Mbikëqyrës të definohet mbikëqyrja dhe kontrolli financiar, por që mungon një akt i tillë i veçantë i Organit Mbikëqyrës të SP, i cili do ta definonte qartë Kontrollin e brendshëm financiar, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës për të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në Neni 17 "Kontrolli i Brendshëm" të Ligjit Nr.03/L-174 "Për financimin e subjekteve

politike” i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-212.SP ka krye një Auditim të Brendshëm- AB financiar për vitin përkatës 2021.

- SP nuk ka shpalosur shenimet mbi pagesate kryera ne vlere mbi 5,000.00Euro nje marresi te vetem për periudhen ashtu siq parashihet ne ligjin NR:04/L-212 per plotesimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr:03/L-174 neni 15/ pika 2.3-per financimin e subjekteve politike te ndryshuar dhe te plotsuar me Ligjin Nr:04/L-058 .

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj sipas parimit të vijimësisë, shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve, dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë reale përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një siguri absolute që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të



vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Nijazi Jakupi
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Bilanci në fundë të periudhës	Bilanci në fillim të periudhës
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	9,500.00	9,500.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		9,500.00	9,500.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	126,012.26	69,063.10
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		126,012.26	69,063.10
Total pasuritë		135,512.26	78,563.10
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		57,196.31	98,214.32
Suficiti / (deficiti) i vitit		58,116.93	(41,018.01)
Total Ekuiteti		135,312.24	57,196.31
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huat e pagueshme			
Të hyrat e shtyra		9,500.00	9,500.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		9,500.00	9,500.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	10,699.02	11,866.79
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		10,699.02	11,866.79
Gjithsej detyrimet		20,199.02	21,366.79
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		135,512.26	78,563.10

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	16 Shtator 2021 deri 12 Nentor 2021
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		87,419.00
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00
Të hyrat tjera		
Gjithsej të hyrat për vitin		87,419.00
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet		7,798.76
Shpenzimet e transportit	2	868.49
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	12,290.00
Blerja e mallrave		
Shpenzimet e përgjithshme	2	8,241.52
Shpenzimet e ndryshme		103.30
Gjithsej shpenzimet për fushatë	2	29,302.07
Suficiti / (deficiti) për vitin		58,116.93

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë
16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

1. Informata te përgjithshme

Subjekti Politikë: **Srpska Lista**
Akronimi: SL
Selija: Mitrovica Veri;
Web faqja: <http://www.srpskalista.net/>
NF: 601543730
E regjistruar: 12.05.2017 numri regjistruar 209-0517
Kryetar : **Goran Rakić**
Përf.i autorizuar
Financier: **Darko Radovanovic**

Pasqyrat financiare te Partisë "SRPSKA LISTA" janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 .

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën BKT.

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Shënimi 2: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	6,600.00	6,600.00	0.00
Pagesat e vëzhguesve			0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	371,38	371,38	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	371.38	371.38	0.00
Tatimet në të ardhura personale	456.00	456.00	0.00
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	7,798.76	7,798.76	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	868.49	868.49	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	868.49	868.49	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	90.00	90.00	0.00
Ushqimi	0.00		0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	0.00		0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00		0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	12,200.00	12,200.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	12,290.00	12,290.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës			
Pajisjet të vogla	0.00	0.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Telefoni, interneti dhe posta	141.52	70.76	70.76
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	0.00		0.00

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Gjoha dhe ndeshkime	8,100.00	8,100.00	0.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			0.00
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	8,241.52	8,170.76	70,76
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	103.30	103.30	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	103.30	103.30	0.00
Gjithsej shpenzimet	29,302.07	29,231.31	70.76

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë

16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				////////	////////////////	////////////////

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

Për periudhën: 16 Shtator /2021 deri më 15/ Tetor/2021

	Blerjet gjatë periudhës
Toka	
Objektet	
Veturat	
Pajisjet e zyrës	
Pajisjet e teknologjisë informative	
Pajisjet tjera	
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	////////////////

Shënime tjera

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë
16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Bleresi-1		
Bleresi-2		
Llogari te arketueshme te tjera		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	//////////	//////////

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Paraja në bankë	126,012.70	69,063.10
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	126,012.70	69,063.10

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
MTS-d.o.o.	70.76	70.76
Slavolub Mandic IB	60.00	60.00
Atk	10,073.51	10,073.51
Sekos	0.00	673.11
Llogari te pagueshme te tjera	0.00	0.00
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	10,204.27	10,877.38

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		0.00
Detyrimet për qira	494.75	989.25
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	0.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		0.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	494.75	989.25

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të fushatës për Zgjedhjet Lokale në Kosovë
16 Shtator 2021 deri me 12 Nentor 2021

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		në euro
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					////////////////////